



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



**RREGULLORE E BRENDSHME
E
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KONSULTATIV
TË QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE**

Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendore me Vetëqeverisjen Vendore, bazuar në nenin 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendore me Vetëqeverisjen Vendore”, me propozim të bashkëkryetarëve të Këshillit,

**VENDOSI:
KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi në mënyrë të detajuar i rregullave të brendshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendore me Vetëqeverisjen Vendore (në vijim referuar “*Këshill Konsultativ*”).

Neni 2

Parimet e organizimit dhe funksionimit

Këshilli Konsultativ organizohet dhe funksionon në bazë të parimit të informimit dhe konsultimit të ndërsjelltë midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, bashkëpunimit dhe dialogut konstruktiv midis tyre, dhe angazhimit të shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të vetë këtyre njësive, transparencës dhe eficiencës duke respektuar në të njëjtën kohë edhe autonominë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 3

Stema dhe logo

1. Këshilli Konsultativ përdor stemën e Republikës së Shqipërisë, ministrit përgjegjës për pushtetin vendor sipas legjislacionit në fuqi, Agjencisë për Vetëqeverisjen Vendore, si dhe logon e posaçme të Këshillit si dhe të shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Logoja e Këshillit Konsultativ përdoret në dokumente e akte të brendshme, në korrespondenca si dhe në çdo veprimtari tjetër që organizohen nga Këshilli.

KREU II

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KËSHILLIT KONSULTATIV

Neni 4

Struktura organizative e Këshillit Konsultativ

Struktura organizative e Këshillit Konsultativ përbëhet nga:

- a) Bashkëkryetarët;
- b) Komisionet e Këshillimit Ad Hoc;
- c) Sekretariati Teknik.

Neni 5

Përgjegjësitë e bashkëkryetarëve

Bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ kujdesen për organizimin dhe funksionimin e Këshillit dhe kryerjen e detyrave të tij në përputhje me parashikimet e VKM-së nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”.

Neni 6

Komisionet e këshillimit Ad Hoc

1. Komisionet e këshillimit Ad Hoc krijohen, sipas nevojës, me vendim të Këshillit Konsultativ, në mbledhjen e parë plenare të vitit, bazuar mbi propozimin e bashkëkryetarëve dhe në mirëkuptim midis anëtarëve. Komisionet e këshillimit funksionojnë si struktura ad hoc për të mbuluar fusha dhe sektorë specifikë që lidhen me funksionet e vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

2. Vendimi për krijimin përfshin emërtimin, përbërjen, kryesimin, objektivat dhe fushën e veprimtarisë së komisionit si dhe afatin e përmbushjes së detyrave.
3. Si rregull, komisionet përfundojnë funksionimin e tyre në fund të vitit kalendarit. Këshilli Konsultativ mund të vendosë të vijojë me funksionimin e të njëjtit komisioni, me shumicën e votave e anëtarëve pjesëmarrës të Këshillit.
4. Këshilli Konsultativ krijon dhe funksionon me të paktën një komision këshillimi Ad Hoc.
5. Në fushën e përgjegjësisë së të gjitha komisioneve bëjnë pjesë edhe çështjet e agjendës së integritetit në Bashkimin Evropian dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj.

Neni 7

Sekretariati Teknik

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ushtron detyrat e Sekretariatit Teknik në përputhje me parashikimet e VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”.

KREU III

KOMISIONET E KËSHILLIMIT AD HOC

Neni 8

Kompetencat e komisioneve

Komisionet e Këshillit Konsultativ janë përgjegjëse për:

- a) shqyrtimin sipas përkatësisë për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që paraqiten për konsultim në Këshill sipas legjislacionit në fuqi;
- b) kryejnë analiza dhe diskutime dhe japin opinione mbi problematikat e politikave qendrore që ndikojnë në funksionet dhe kompetencat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore apo financat vendore;
- c) propozojnë në përputhje me parashikimet e nenit 19 të kësaj rregullore nisma dhe iniciativa për ndryshime ligjore dhe rregullatore.
- ç) ushtrojnë kompetencat sipas parashikimeve të kësaj rregullore.

Neni 9

Anëtarësia në komisione

1. Në komisionet e këshillimit Ad Hoc marrin pjesë përkatësisht nga 3 përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore në përputhje me ndarjen e anëtarësisë sipas VKM-së nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”.
2. Anëtarët përfaqësues nga qeverisja qendrore mund të jenë zyrtarë të nivelit të lartë/mesëm drejtues. Të paktën një anëtar i komisionit, përfaqësues nga qeverisja qendrore, duhet të jetë nga ministria përgjegjëse për financat vendore.

3. Anëtarët e qeverisjes vendore emërohen nga shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe emërimet garantojnë balancimin e faktorëve politikë, gjeografikë, demografikë dhe gjinorë në anëtarësinë e komisioneve. Të paktën dy anëtarë të komisionit emërohen nga shoqata përfaqësuese e bashkive.
4. Përfaqësuesit e qeverisjes qendrore dhe vendore caktojnë përfaqësuesin e tyre zëvendësues, për të marrë pjesë në takimet e komisionit, që duhet të jetë zyrtar i nivelit të mesëm/ulët drejtues.
5. Si rregull, anëtari i një komisioni mund të marrë pjesë edhe në komisionin(et) tjetër. Bashkëkryetarët nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit.
6. Këshilli Konsultativ mund të ndryshojë përbërjen, duke ruajtur barazinë në përbërje.

Neni 10

Organizimi i punës së komisioneve

1. Komisioni kryesohet me rotacion çdo 6 muaj nga një anëtar duke ruajtur parimin e kryesimit një herë nga qeverisja qendrore dhe një herë nga ajo vendore. Si kryetar i komisionit për herë të parë shërben anëtari nga qeverisja vendore.
2. Kryetari i komisionit përfaqëson komisionin, organizon dhe drejton mbledhjet e komisionit, si dhe siguron respektimin e procedurave, sipas kësaj Rregulloreje. Në rast se kryetari mungon ose është në pamundësi të zhvillojë mbledhjen, mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë që i përket qeverisjes qendrore.
3. Anëtarët e komisionit duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e komisionit. Kur një anëtar i tij mungon pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje, në mbledhjen plenare mund të kërkohet zëvendësimi i tij me vendim të Këshillit.
4. Komisioni mund të asistohet nga ekspertë të jashtëm të propozuar nga shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore për çështje teknike dhe ekspertizë të specializuar në fushën përkatëse.
5. Në dhjetor të vitit kalendarik përgatitet një raport i përmbledhur mbi veprimtarinë e komisionit që paraqitet për diskutim në mbledhjen plenare dhe bëhet pjesë e analizës vjetore mbi aktivitetin e Këshillit Konsultativ.

KREU IV

ORGANIZIMI I PUNIMEVE TË KËSHILLIT KONSULTATIV DHE KOMISIONEVE TË TIJ

Neni 11

Periodiciteti i takimeve të Këshillit Konsultativ

Si rregull, Këshilli Konsultativ zhvillon mbledhje në mënyrë periodike, duke respektuar, për aq sa është e mundur, frekuencë takimi javën e fundit të muajit kalendarit.

Në të gjitha rastet, respektohen afatet e parashikuara në pikat 15, 17 dhe 23 të VKM-së nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”.

Neni 12

Programi i punës së Këshillit Konsultativ

1. Këshilli Konsultativ zhvillon punimet në seancë plenare dhe në mbledhje pune në komisione, sipas një programi pune vjetor të dakordësuar me mirëkuptim midis anëtarëve.

2. Programi i punës përbëhet nga:

a) projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që paraqiten për konsultim pranë Këshillit Konsultativ dhe që nuk bëjnë pjesë në aktet e parashikuara në shkronjën b) dhe c) të kësaj pike, por që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

b) projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që janë parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin kalendarik përkatës, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

c) projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që janë parashikuar në planin kombëtar për integrimin evropian sipas legjislacionit në fuqi dhe që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Sekretariati teknik i Këshillit Konsultativ vlerëson të gjitha aktet e parashikuara në pikën 1, shkronja b) dhe c) dhe identifikon ato projektligje, projektvendime të Këshillit të Ministrave, projektpolitika dhe projektstrategji që lidhen me fusha dhe sektorë specifikë të funksioneve të vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe që paraqesin interes të veçantë për përfshirje të hershme të njësive të vetëqeverisjes vendore. Procesi i vlerësimit të akteve përmbyllet brenda muajit janar të vitit kalendarik.

3. Në listë mund të përfshihen edhe akte që nuk janë parashikuar në dokumentet e përmendur në pikën 1, shkronjat a), b) dhe c), por që nga natyra e problematikës së hasur nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe nevoja për adresim, janë të tilla që justifikojnë diskutimin dhe ndërmarrjen e nismës në mënyrë proaktive për adresimin e tyre.

4. Lista e akteve paraqitet për shqyrtim në mbledhjen plenare të radhës të Këshillit Konsultativ. Lista përmban institucionin përgjegjës që do të ndërmarrë nismën, afatet e parashikuara si dhe aspektet që duhet të adresohen nga pikëpamja e njësive të vetëqeverisjes vendore në lidhje me atë akt.

5. Në programin e punës së Këshillit Konsultativ futen automatikisht projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që paraqiten për konsultim e parashikuara në pikën 1, shkronja a).

6. Programi i punës u shpërndahet anëtarëve dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit Konsultativ.

Neni 13

Procedura e shqyrtimit të projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe projektligjeve financiare

1. Kryetari i komisionit përgjegjës për financat vendore organizon punën për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të në përputhje me afatet e parashikuara në pikën 27 të VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”.
2. Komisioni mund të organizojë seanca konsultuese të posaçme me përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore me qëllim marrjen e vërejtjeve dhe mendimeve për projektligjin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me financat e vetëqeverisjes vendore.
3. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni harton një raport ku evidentohen rekomandimet për projektligjin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet financiare që i dërgohet për vlerësim mbledhjes plenare të Këshillit Konsultativ.

Neni 14

Bashkëpunimi i komisioneve me strukturat e partneritetit që lidhen me politikat e kohezionit dhe zhvillimit rajonal

1. Komisionet mund angazhohen dhe bashkëpunojnë me çdo strukturë partneriteti që shërben si mekanizëm kombëtar bashkëpunimi apo konsultimi për programimin, përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e fondeve të politikave të kohezionit të BE-së.
2. Në kuadër të këtij ndërveprimi, komisionet mund të hartojnë rekomandime apo opinione që, pasi diskutohen në mbledhjen plenare, i përcillen strukturave përkatëse.

Neni 15

Programi i punës i komisioneve këshillimore Ad Hoc

1. Çdo komision përcakton programin e punës dhe kalendarin e punimeve të tij në përputhje me parashikimet e pikave 26 dhe 27 të nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”. Si rregull, ata hartohen duke mbajtur parasysh programin e punës të Këshillit të parashikuar në nenin 12 të kësaj Rregullore.
2. Kryetari i komisionit, në mirëkuptim me anëtarët e tjerë, nisur nga rëndësia e çështjes që do të shqyrtohet, cakton një relator për çështjen që do të shqyrtohet.

Neni 16

Mënyra e organizimit të punës të komisioneve këshillimore Ad Hoc

1. Komisionet këshillimore Ad Hoc mblidhen rregullisht, me prezencë fizike ose online të anëtarëve.
2. Mbledhjet e komisionit thirren nga kryetari i tij, ose me kërkesë të anëtarëve përfaqësues të njësisë të vetëqeverisjes vendore, duke përcaktuar në kërkesë edhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje.
3. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur në to merr pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të komisionit.
4. Komisioni merr vendim me votim të hapur me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë e parashikuara në nenin 11, pika 1 të kësaj Rregullore. Mendimi i anëtarëve që nuk kanë shprehur dakordësinë dhe kanë mbetur në pakicë, në çdo rast shënohet në procesverbalin e përmbledhur që i dërgohet Sekretariatit Teknik për t'u shpërndarë në mbledhjen plenare.

Neni 17

Seanca dëgjimore me përfaqësues të qeverisjes qendrore

1. Anëtarët e qeverisjes vendore në Këshillin Konsultativ mund të kërkojnë me shkrim seancë dëgjimore të posaçme me përfaqësues të qeverisjes qendrore që janë anëtar të Këshillit në lidhje me çështje që lidhen me nismat ligjore, zbatimin e legjislacionit apo çdo aspekt tjetër që ka ndikim të drejtëpërdrejtë në fusha dhe sektorë specifikë që lidhen me funksionet e vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.
2. Kërkesa i drejtohet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, në cilësinë e bashkëdrejtuesit të Këshillit.
3. Seanca dëgjimore organizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, në kuadër të mbledhjes pasuese të Këshillit Konsultativ. Anëtarët paraqesin me shkrim pranë Sekretariatit Teknik paraprakisht, pyetjet apo çështjet që do t'i nënshtrohen diskutimeve.
4. Sekretariati Teknik harton një procesverbal të përmbledhur të diskutimeve që publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ.

Neni 18

Seanca konsultuese me aktorë të tjerë

1. Komisioni mund të organizojë seanca konsultuese me përfaqësues të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara për ato çështje që lidhen me fusha dhe sektorë specifikë të funksioneve e vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe që paraqesin interes të veçantë për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
2. Kryetari i komisionit raporton në mbledhjen plenare në lidhje me diskutimet në seancat konsultuese dhe rezultatet e tyre përkundrejt akteve që shqyrtohen dhe vlerësohen nga Këshilli Konsultativ.

Neni 19

Shqyrtimi i çështjeve

1. Komisioni fillimisht kryen diskutimin në parim të projektaktit ose të çështjes. Relatori paraqet vlerësimin e përgjithshëm mbi projektligjin ose çështjen që diskutohet, si dhe vlerësimin mbi efektet e pritshme në lidhje me ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Anëtarët e Komisionit paraqesin mendimet e tyre dhe diskutojnë aspektet përkatëse të projektaktit.
2. Për projektaktet që synojnë përafrimin me *acquis*, pjesa e tekstit që ka të bëjë me detyrimin për përafrimin e legjislacionit merret në konsideratë pa ndryshime dhe mund të propozohen vetëm aspekte që lehtësojnë zbatimin për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
3. Si rregull, për mbledhjet e komisionit mbahet edhe procesverbal i përmbledhur, ku shënohet data e zhvillimit të mbledhjes, çështja që shqyrtohet, pjesëmarrja, përmbledhja e diskutimeve të bëra, qëndrimet dhe rezultati i votimit. Procesverbali i përmbledhur i bashkëngjitet dokumentacionit të mbledhjes plenare që i shpërndahen anëtarëve të Këshillit Konsultativ.

KREU V

PROCEDURA PËR PARAQITJEN DHE VLERËSIMIN E NISMAVE NGA PËRFAQËSUESIT E VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 20

Propozimi i nismës nga përfaqësuesit e vetëqeverisjes vendore

1. Përfaqësuesit e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtën të propozojnë nisma për ndryshime të projektligjeve, projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë në fusha dhe sektorë specifikë që lidhen me funksionet e vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.
2. Kërkesa për të hartuar një nismë ligjore në lidhje me ndryshimet diskutohet në parim mbledhjen plenare. Këshilli Konsultativ vendos mbi nevojën për të hartuar nismën.

Neni 21

Procedura e vlerësimit të nismës nga komisioni dhe Këshilli Konsultativ

1. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit në komision, kryetari i komisionit paraqet në mbledhjen e radhës propozimet e dakortësuara. Nisma hartohet në formën e një dokumenti që përmban:
 - a) objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij;
 - b) argumentet se përse objektivat nuk mund të arrihen me instrumentet ligjore ekzistuese;
 - c) ndikimin e pritshëm ekonomik, financiar, social, mjedisor në nivel vendor.
2. Këshilli Konsultativ vendos për përcjelljen e nismës pranë ministrisë së linjës përkatëse apo institucionit shtetëror që ka të drejtën të propozojë nismën. Dokumenti që përmban propozimet si

dhe procesverbali përmbledhës i diskutimeve të Këshillit i bashkëngjiten shkresës përcjellëse nga Sekretariati Teknik.

KREU VI

MBLEDHJET PLENARE DHE TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KONSULTATIV

Neni 22

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës që i dërgohet të gjithë anëtarëve përmban:
 - a) Datën dhe orën e caktuar për mbledhjen e Këshillit;
 - b) Listën e projektakteve dhe/ose çështjeve që do të diskutohen;
 - c) Dokumentet shoqërues të projektakteve;
 - ç) Opinionet, rekomandimet që propozohen për aktin (nëse ka të tilla).
2. Njoftimi për mbledhjen së bashku me dokumentet shoqërues i dërgohen menjëherë anëtarëve dhe shoqatave përfaqësuese, si dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ.

Neni 23

Zhvillimi i mbledhjeve

1. Në fillim të çdo mbledhje, bashkëkryetari, që është njëkohësisht ministri përgjegjës për pushtetin vendor, bën të njohur rendin e ditës dhe çështjet që do t'i nënshtrohen diskutimeve.
2. Këshilli mund të diskutojë dhe të vendosë për çështje që nuk janë në rendin e ditës, me propozim të çdo anëtar, me vendim të jo më pak se gjysmës së anëtarëve që marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit.
3. Lejohet ndërrimi i radhës së diskutimeve të pikave në rendin e ditës në marrëveshje mes anëtarëve të Këshillit.

Neni 24

Rradha e diskutimeve

1. Diskutimi sipas rendit të ditës fillon me prezantimin e aktit nga ministria apo institucioni propozues i nismës, që është deri 10 minuta. Më pas, relatori i komisionit që ka shqyrtuar këtë nismë parashtron diskutimet dhe rekomandimet përkatëse.
2. Pozicionet apo mendimet e shoqatave përfaqësuese dhe të përfaqësuesve të qeverisjes vendore mund të shprehen në një numër më të kufizuar diskutimesh ose nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar nga ato.
3. Nuk lejohet më shumë se një diskutim nga një anëtar për të njëjtën pikë të rendit të ditës.

Neni 25

Koha e diskutimeve

1. Si rregull, koha e diskutimeve për çdo anëtar, për çdo pikë të rendit të ditës, është deri në 5 minuta. Bashkëdrejtuesi i seancës, për shkak të rëndësisë së çështjes, mund të vendosë paraprakisht zgjatjen e kësaj kohe.
2. Anëtari i Këshillit Konsultativ ka të drejtën e replikës kur ndaj tij janë bërë diskutime që kanë shtrembëruar (devijuar) thelbin e fjalës së tij. Replika bëhet menjëherë pas diskutimit dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 2 minuta. Për të njëjtin diskutim, anëtari nuk mund të bëjë më shumë se një replikë. Anëtari dhe anëtarët e tjerë të Këshillit nuk lejohen të bëjnë replikë ndaj replikës.

Neni 26

Pjesëmarrja dhe Sjellja

1. Anëtarët e Këshillit Konsultativ duhet të respektojnë kalendarin dhe rregullat e drejtimit të mbledhjes. Përgjatë punimeve të Këshillit Konsultativ, anëtarët e Këshillit fokusohen tek themeli i çështjeve për diskutim, efekti i tyre për të dy nivelet e qeverisjes dhe përmirësimi i shërbimeve publike, duke evituar përdorimin e gjuhës ofenduese dhe joetike apo çdo sjellje të padenjë që pengon zhvillimin normal të mbledhjeve dhe diskutimeve.
2. Anëtarët marrin masa për të siguruar pjesëmarrjen e tyre ose të deleguarit të tyre në mbledhje, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së përfaqësimit në punimet e Këshillit Konsultativ.

Neni 27

Vendimet e Këshillit Konsultativ

1. Këshilli Konsultativ mund të miratojë rekomandime konkrete drejtuar institucioneve të qeverisjes qendrore apo institucioneve të tjera publike.
2. Rekomandimet paraqiten nga kryetari i komisionit këshillimor Ad Hoc ose nga bashkëkryetarët, në përfundim të diskutimeve dhe hidhet në votim nga bashkëkryetarët.
3. Gjatë procesit të votimit nuk lejohen diskutime dhe replika, me përjashtim të propozimeve për ndryshime të formulimeve për tekstin e tij.
4. Rekomandimi quhet i miratuar nëse për të kanë votuar ‘pro’ të gjithë anëtarët e njësisë të vetëqeverisjes vendore në Këshill. Në rast se nuk arrihet konsensusi për të miratuar rekomandimin, mendimet e të gjithë anëtarëve të vetëqeverisjes vendore, pasqyrohen në procesverbalin e përmbledhur.
5. Procesverbali i përmbledhur që përmban rekomandimet apo mendimet e përfaqësuesve të njësisë të vetëqeverisjes vendore, në mbështetje ose jo të projektakteve të propozuara të qeverisjes

qendrore, i bashkëlidhet praktikës dokumentare që shoqëron procesin vijues të vendimmarrjes përkatëse në Këshillin e Ministrave ose në Kuvend.

Neni 28

Procesverbali i mbledhjeve

1. Diskutimet e mbledhjeve të Këshillit pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në procesverbal që publikohet në faqen e internetit të Këshillit Konsultativ. Vendimi i Këshillit firmoset nga bashkëkryetarët.
2. Sekretariati Teknik përgatit procesverbalin e përmbledhur jo më vonë se 7 ditë nga mbajtja e mbledhjes.
3. Procesverbali i përmbledhur përmban datën dhe çështjet e diskutuara në mbledhje, pjesëmarrjen e anëtarëve dhe të ftuarve të tjerë, si dhe përmbledhje të diskutimeve të bëra apo votimit për rekomandim nëse ka të tillë.
4. Procesverbali i dërgohet anëtarëve të Këshillit Konsultativ të cilët kanë të drejtë të paraqesin komentet e tyre brenda 3 ditë nga momenti i marrjes së tyre.

Neni 29

Dokumentacioni i Këshillit Konsultativ

1. Dokumentacioni i Këshillit Konsultativ përfshin:
 - a) procesverbalet të diskutimeve në mbledhjet plenare;
 - b) dokumentet që lidhen me përgatitjen e mbledhjeve plenare dhe të komisioneve;
 - c) publikimet apo botimet në faqen zyrtare të internetit.
2. Dokumentacioni mbahet edhe në një regjistër elektronik që janë drejtpërdrejt të aksesueshme nga publiku në faqen e internetit të Këshillit.

Neni 30

Raporti vjetor i Këshillit Konsultativ

1. Brenda janarit të muajit pasardhës, Sekretariati Teknik harton raportin vjetor mbi veprimtarinë e Këshillit për vitin pararendës. Raporti përfshin analizën e punës të Këshillit dhe komisioneve, përfshirë numrin e rekomandimeve që janë përgatitur nga komisionet dhe numrin e atyre të marrë në konsideratë nga qeverisja qendrore dhe një përmbledhje të atyre që janë refuzuar së bashku me arsyetimet përkatëse. Sekretariati Teknik ndërvepron dhe kërkon informacion nga ministrinë e linjës dhe institucionet propozuese në lidhje me numrin e rekomandimeve të marra parasysht.
2. Raporti vjetor i dërgohet të gjithë anëtarëve të Këshillit Konsultativ dhe nëse kërkohet nga njëri nga bashkëkryetarët i nënshtrohet diskutimit në seancë plenare.
3. Raporti vjetor publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ.

KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 31

Ndryshimi i Rregullores

1. Çdo anëtar i Këshillit Konsultativ ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në këtë Rregullore. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektakteve.
2. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Konsultativ.

Neni 32

Krijimi i komisioneve Ad Hoc

1. Përjashtimisht për vitin 2025, komisionet këshillimore Ad Hoc krijohen pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe do të funksionojnë deri në fund të dhjetorit të vitit 2025.
2. Këshilli Konsultativ mund të vendosë që në vitin 2025 të funksionojë vetëm me një komision këshillimor Ad Hoc.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Këshilli Konsultativ.